

UDHËZIM
Nr. 33, datë 2.12.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 7, DATË 7.5.2007, “PËR PËRDORIMIN
E FONDIT TË SHPRONËSIMEVE”**

Në mbështetje të nenit 104, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 6, të ligjit nr. 10296, datë, 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 395, datë 13.5.2020, “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin”, udhëzimit nr. 7, datë 7.5.2007, “Për përdorimin e fondit të shpronësimeve”, si dhe të propozimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (shkresa nr. 799, datë 2.11.2022, “Propozim për ndryshimin e udhëzimit nr. 7, datë 7.5.2007”), ministri përgjegjës për financat e qeverisë,

UDHËZON:

1. Pika 1 e udhëzimit nr. 7, datë 7.5.2007, “Për përdorimin e fondit të shpronësimeve”, ndryshohet si më poshtë:

“Agjencia Shtetërore për Shpronësimin nëpërmjet Ministrisë së infrastrukturës dhe Energjisë paraqet në strukturën përgjegjëse për Thesarin në qendër, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, kërkesën për shpronësim, e cila duhet të ketë bashkëngjitur vendimin e Këshillit të Ministrave për shpronësimin e kërkuar.”

2. Pika 3 e udhëzimit nr. 7, datë 7.5.2007, “Për përdorimin e fondit të shpronësimeve”, ndryshohet si më poshtë:

“3. Pagesa e të shpronësuarve të bëhet si vijon:

- Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave, për çdo pronar privat apo subjekt të shpronësuar krijon dosjen përkatëse, në përputhje me ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar.

- Me përfundimin e kompletimit ligjor të dosjes, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin harton listëpagesën për dosjet e përfunduara (sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi).

- Listëpagesa e miratuar zyrtarisht nga titullari i Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, i bashkëngjitet kërkesës zyrtare dhe paraqitet për pagesë nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë pranë ministrit përgjegjës për financat.”

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen njësitë e pushtetit ekzekutiv në njësitë e qeverisjes qendrore, strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

4. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj